



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1592/2 Prot.

Tiranë, më 30 . 12 . 2024

**V E N D I M**

Nr. 326, datë 30 . 12 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 246 Regj., datë 27.11.2024, paraqitur nga shtetasi A. Ç kundër: Komisarariatit të Policisë nr. 6, Tiranë, Shërbimit Përmbarrimor Shtetëror Tiranë dhe znj. V. D, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Referuar formularit të ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, z. A. Ç, parashton se, është baba i dy fëmijëve të lindur nga martesë me shtetasen V. D, ish-bashkëshortja e tij. Ndër të tjera, ai citon se:

*“Martesa me ish-bashkëshorten time është zgjidhur me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, që sipas ligjit përbën titull ekzekutiv. Në këtë vendim është përcaktuar se, ish-bashkëshortja ka të drejtën të mbajë për rritje dhe edukim fëmijët tanë, me të drejtën time për t’i takuar ata çdo fundjavë, sipas fashave të orareve të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.*

*Në vitin 2018, ish-bashkëshortja ime ka bërë një kërkesë drejtuar Shkollës ku mësonin fëmijët e mi, duke i kërkuar Drejtorit të saj që, unë si prind të mos afrohem dhe të mos kem asnjë mundësi*

---

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

*kontakti me ta. Policët e Komisariatit nr. 6, Tiranë, kanë komunikuar me rojën e kësaj Shkolle, ku e kanë informuar këtë të fundit se, nëse shtetasi A. Ç afrohet në shkollë për të marrë kontakte me fëmijët, na thoni në mënyrë që ta arrestojmë.*

*Ndodhur përpara këtij fakti, në momentin që u vura në dijeni nga roja i Shkollës mbi sa më sipër, jam drejtuar me ankesë në SHÇBA (Sot Agjencia e Mbikëqyrjes Policore/AMP) për marrjen e masës disiplinore ndaj tyre.*

*Rasti i dy policëve të sipërpërmendur, është adresuar nga ana e AMP-së, në Drejtorinë e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi AMP-ja, evidentoi shkeljet në kapërcim të kompetencave ligjore nga ana e punonjësve të policisë. Në vijim, rreth vitit 2022, persona të tretë, më kanë informuar se, djali im, K. Ç, ka dalë nga shkolla me pranga në duar, për shkak të një konflikti të ndodhur aty.*

*I jam drejtuar Komisariatit nr. 6, Tiranë, me shkresë zyrtare për të më njohur me arsyet e arrestimit të djalit tim. Pasi nuk po merrja përgjigje mbi shkaqet e ndalimit të djalit tim, jam ankuar sërish tek AMP-ja kundrejt dy punonjësve të policisë, për mosdhënie informacioni, duke dyshuar se ky fakt, kishte të bënte me hatërmbetjet e vitit 2018, ku ndaj dy punonjësve të këtij Komisariati, u mor masa disiplinore.*

*AMP, pas verifikimeve të kryera në kuadër të ankesës sime zyrtare konstatoi se nuk kishte shkelje. Në lidhje me informacionin e kërkuar mbi shkaqet e ndalimit të djalit tim në Komisariatit nr. 6, Tiranë, më bënë të ditur mbi ekzistencën e një shkrese, ku pretendohet se Komisariati i ka kthyer përgjigje zyrtare kërkesës sime për informacion, lidhur me shkaqet e ndalimit të djalit tim K. Ç.*

*Posta Shqiptare më ka kthyer përgjigje zyrtare se në emrin tim nuk kishte asnjë korrespondencë zyrtare nga ana e Komisariatit nr. 6, Tiranë. Në këto kushte, i jam drejtuar sërish AMP-së, duke u vënë në dispozicion edhe përgjigjen e Postës Shqiptare.*

*AMP, më kthen përgjigje duke më deklaruar se, përgjigja ka ardhur në adresë të djalit K. Ç. Duke mos kuptuar arsyet se përse shkresa i është përcjellë djalit tim, në atë kohë të mitur, kam deponuar me kallëzim penal ndaj titullarëve të AMP-së, kallëzim për të cilin Prokuroria e Tiranës ka disponuar me vendim mosfillimi të procedimit penal, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.*

*Kundrejt punonjësve të Komisariatit nr. 6, Tiranë, kam disponuar kallëzim penal për konsumim të veprës penale të shpërdorimit të detyrës. Prokuroria e Tiranës, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.*

*Mbi bazën e ankimit tim, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të Prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe detyrimin e*

*organit të akuzës për regjistrimin e procedimit penal dhe vijimin e mëtejshëm të hetimeve. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në vijim, kam kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, Vendimit nr. 463, datë 28.03.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila më ka dhënë të drejtën për të takuar fëmijët e mi çdo fundjavë.*

*Përmbartimi Shtetëror, Zyra Vendore Tiranë, ka thirrur debitoren, ish-bashkëshorten me qëllim të vërë në dispozicionin tim (të kreditorit A. Ç), fëmijët e mi, sipas titullit të vendimit të gjykatës.*

*Përmbartimi Shtetëror Tiranë, në praninë e psikologut, ka mbajtur procesverbal ku pasqyrohet se fëmijët e mi nuk duan të takohen me ankuesin, e në këto kushte, me kërkesën e ankuesit, është kërkuar pushimi i mëtejshëm i ekzekutimit të titullit ekzekutiv të gjykatës.”*

Duke çmuar se, gjithë këto procedura janë ndjekur në mënyrë të paligjshme ndaj ankuesit A. Ç, ku nëna e fëmijëve të tij, V. D, në mënyrë të vazhdueshme ka ndërmarrë veprime të paligjshme me qëllim për të mos lejuar kontaktin me fëmijët e tij, duke ndërhyrë në institucionet shtetërore dhe policore, po ashtu edhe në institucionet shkollore ku studiojnë fëmijët, ankuesi i drejtohet Komisionerit për të hetuar mbi shkaqet e këtyre veprimeve, pasi i lind dyshimi i arsyeshëm bazuar në prova se, të gjitha procedurat që kanë ndjekur institucionet e mësipërme, subjekte ndaj të cilave kundërdrejtohet kjo ankesë, e kanë diskriminuar për shkak të gjinisë, duke i dhënë përparësi ish-bashkëshortes së tij, në çdo vendimmarrje të saj, mbi fëmijët.

Ankuesi vijon se: *“Siç përmend më sipër, ndaj punonjësve të policisë është dhënë masë disiplinore. Pra këta punonjës, të instruktuar nga Drejtori i Shkollës, kanë ndërhyrë në mundësinë për të takuar fëmijët dhe për të patur kontakte me ta .Duke mos qenë dakord me masën disiplinore të dhënë ndaj tyre, kam disponuar kallëzim penal, ku pas shqyrtimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka detyruar Prokurorinë të vijojë hetimet e të regjistrojë procedimin penal.*

*Gjithashtu, kam disponuar edhe kallëzim penal kundrejt z. Muhamet Rrumbullaku dhe z. A. Ç, si titullarët përgjegjës të SHÇBA-së, sot AMP, pasi këta titullarë nuk kanë hetuar në drejtim të pasojave të ardhura nga oficerët e policisë, ndaj të cilëve është marrë masa disiplinore. Ata nuk kanë hetuar mbi faktin se, përse përgjigjja e Komisarariatit nr. 6, Tiranë, ka ardhur në adresë të fëmijës K. Ç, i mitur në atë kohë, dhe jo në adresën e ankuesit, duke qenë se ai e ka adresuar dhe kërkesën zyrtare. Pra, si është lejuar që, përgjigjja e Komisarariatit për shkaqet e ndalimit të fëmijës K. Ç ka shkuar në adresën e fëmijës së mitur dhe jo të prindit i cili ka bërë kërkesën.*

*Duke mos marrë kontakte me fëmijët, nuk kam patur mundësi të kem një ndikim mbi sjelljen e tyre dhe nuk do të ishte kryer veprimi kriminal i plagosjes së një nxënësi tjetër në atë shkollë nga fëmija im i mitur, në atë kohë, K. Ç. Këto veprime dyshoj se lidhen me ish-bashkëshorten time, pasi është kjo e fundit e cila, në mënyrë të njëanshme ka kërkuar mbrojtje ndaj meje nga Policia e Shtetit, me qëllim për të më larguar edhe nga kontakti me fëmijët e mi.*

*Nga ana e Përmbarduesit veprimet konsistojnë në faktin se, ato kanë mbetur veçse formale, pasi deri më sot nuk kam mundur të kem kontakte me fëmijët...*

*Gjithashtu, bëj me dije se, ish-bashkëshortja ime, ka ndryshuar edhe shkollën e vajzës sime, duke e transferuar atë, pa pëlqimin tim, në një shkollë tjetër. Në këto kushte, jam izoluar totalisht nga kontakti me fëmijët e mi, si prind i tyre.*

*Për sa më sipër, shtetasja V. D, Komisariati nr.6, Tiranë, institucionet shkollore ku studiojnë fëmijët e mi, së bashku me Përmbardimin Shtetëror Vendor Tiranë, kanë konsumuar veprime të paligjshme ndaj meje, duke favorizuar ish-bashkëshorten time, duke më privuar nga e drejta e takimit me fëmijët e mi, në zbatim të vendimit të gjykatës...”*

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “*Konstatimin e diskriminimit nga ana e subjekteve kundër të cilave kam paraqitur ankesën, si dhe marrjen e masave për urdhërimin e autoriteteve publike për të mundësuar kontaktin, informacionin dhe aksesimin e fëmijëve të mi, si një e drejtë ligjore dhe njerëzore e cila më është njohur edhe me vendim gjykatë.”*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Bazuar në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, evidenton se, situata faktike dhe pretendimet e ankuesit për secilin nga subjektet respektive, në kronologji kohore, paraqiten si vijon:

- Me Vendimin nr. 9189, datë 15.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur zgjidhja e martesës mes subjektit ankues dhe ish-bashkëshortes së tij V. Ç (D).

Në dispozitivin e këtij Vendimi, ndër të tjera, disponohet si vijon:

- “*Lënia e fëmijëve K. Ç, i datëlindjes 29.06.2006 dhe F. Ç e datëlindjes 19.03.2013, për rritje dhe edukim paditëses V. Ç.*
- ... *Të drejtën e të paditurit A. Ç që të takojë dhe të marrë fëmijët K dhe F. Ç, çdo fundjavë të çdo muaji, nga ora 15:00 e ditës së premte, deri në orën 16:00 të ditës së shtunë dhe t'i marrë për pushime në shtëpi në periudhat 01-05 prill, 15-30 gusht dhe 25-30 dhjetor, të çdo*

*viti. Banesa e fëmijëve është në banesën e nënës dhe fëmijët të merren dhe të kthehen nga i padituri në banesën e paditëses.*

*...Bashkë me vendimin lëshohet urdhri i ekzekutimit...*

- Vendimi i mësipërm është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me Vendimin nr. 463, datë 28.03.2018, ka vendosur: “Lënien në fuqi të Vendimit nr. 9189, datë 15.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me ndryshimin:  
“...Të drejtën e të paditurit A. Ç të takojë fëmijët K. Ç dhe F. Ç çdo javë, nga ora 15:00 e ditës së premte, deri në orën 16:00 të ditës së shtunë.  
Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për këtë vendim.”

➤ **Lidhur me pretendimet e ankuesit kundrejt dy punonjësve dhe strukturave përkatëse hierarkike të Komisarariatit të Policisë nr. 6, Tiranë dhe Drejtuesit të Shkollës së dy fëmijëve të tij<sup>2</sup>.**

*Në një kronologji kohore, situata e parë, sipas deklarimeve të ankuesit, mbështetur dhe nga dokumentacioni i depozituar, për të cilën pretendon sjellje e veprime diskriminuese karshi tij, nga ana e Drejtuesit të Shkollës ku studionin fëmijët e tij<sup>3</sup> dhe dy punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë nr.6, Tiranë, lidhet me vitin shkollor 2018, kur sipas tij, ish-bashkëshortja ka paraqitur një kërkesë drejtuar Shkollës duke kërkuar që ankuesi të mos lejohej të takohej apo t’u afrohej fëmijëve K dhe F. Ç, nxënës të kësaj Shkollë.*

Këtë situatë dhe problematikë të krijuar, dhe veprimet e paligjshme të subjekteve, sipas tij, ankuesi i ka ndjekur qoftë administrativisht, duke i ankimuar në strukturat përkatëse hierarkike të Policisë së Shtetit, qoftë edhe gjyqësisht në organet përkatëse të drejtësisë, të cilat në përfundim të shqyrtimit e hetimeve përkatëse, janë shprehur dhe kanë dalë me vendimmarrjet respektive lidhur me pretendimet e palës ankuese.

*Situata e dytë, sipas deklarimeve të ankuesit, mbështetur dhe nga dokumentacioni i depozituar, për të cilën pretendon sjellje e veprime diskriminuese karshi tij, nga ana e dy punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë nr.6, Tiranë, dhe strukturave përkatëse hierarkike të tyre (AMP-së) lidhet me një ngjarje të ndodhur më datë 01.02.2022, kur pas një incidenti dhe dyshimit për përfshirje në një konflikt me armë të ftohta të djalit të tij të mitur (në atë kohë) në ambientet e Shkollës, ai është shoqëruar nga punonjësit e policisë në Komisarariatin e Policisë nr. 6, Tiranë, duke e nxjerrë me pranga në duar nga ambientet e Shkollës.*

Lidhur me këtë ngjarje, ankuesi citon se nuk është njoftuar nga asnjë institucion shtetëror, përfshirë Shkollën apo Komisarariatin e Policisë nr.6, Tiranë, ku ishte bërë shoqërimi i të birit, të mitur, por

---

<sup>2</sup> Përfshirë edhe ish-bashkëshorten, për të cilën pretendon të ketë nxitur apo ndikuar këto subjekte për veprimet e tyre të mëpasshme kundrejt tij.

<sup>3</sup> Ankuesi nuk citon shkollën ku ndiqnin procesin mësimor fëmijët e tij.

njoftimin e ka marrë privatisht nga persona të tjerë. Vetëm pas interesimit të tij, ka konfirmuar vërtetësinë e kësaj ngjarjeje.

Ankuesi ka paraqitur kërkesë me shkrim, duke kërkuar informacion nga ana e institucioneve arsimore dhe Komisarariatit nr.6, Tiranë, me datë 07.02.2022, çka provon se ai ka marrë dijeni lidhur me ngjarjen e ndodhur.

Nga komunikimet shkresore me Komisarariatit e Policisë nr. 6, Tiranë dhe strukturat në nivel hierarkik të tij, evidentohet se ankuesi pretendimet e tij për shkeljet e konsumuara nga ana e këtyre strukturave në raport me të drejtat e tij si prind i fëmijës K. Ç, por dhe të vetë fëmijës të mitur në atë kohë, i ka ngritur dhe kërkuar qoftë administrativisht, qoftë gjyqësisht, duke prezumuar marrjen dijeni të tyre që në muajin shkurt 2022, kohë kur datojnë e dokumentohen shkresërisht.

- Subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e subjekteve kundrejt të cilëve ka paraqitur ankesën, që në vitin 2018, lidhur me situatën e parë të pretenduar prej tij dhe në muajin shkurt 2022, lidhur me situatën e dytë të pretenduar; kohë kur dhe faktohet e dokumentohet shkresërisht marrja dijeni nga ana e z. Ç për veprimet a sjelljet e paligjshme të kontestuara.
- Ndërkaq, ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 27.11.2024, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetasit A. Ç, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>4</sup>.

Pra, konkludojmë së janë tejkuluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- **Lidhur me pretendimet e ankuesit për mosveprime të Zyrës Përmbarimore Tiranë, në kuadër të zbatimit të Urdhrit të Ekzekutimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.**

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime ndaj dy përmbaruesve të Zyrës Përmbarimore Tiranë, lidhur me veprimet e mosveprimeve të tyre, përsa i takon:

---

<sup>4</sup> Për analogji citojmë Vendimet e KMD-së: me nr. 17, datë 25.01.2023, nr. 125, datë 05.07.2023, nr. 193, datë 09.10.2023, etj.

- Moszbatimit të vendimit nr. 463, datë 28.03.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, lidhur me oraret e takimit me fëmijëve e tij të mitur K dhe F. Ç, duke i mohuar të drejtën e takimit me ta;
- Ndërhyrjes favorizuese dhe njëanshmërisë së treguar nga ana e kësaj Zyre, në favor të ish-bashkëshortes, lidhur me zbatimin e vendimit sipërcituar, të Gjykatës.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, i ndryshuar, në nenin 2 , të tij, ka përcaktuar se:

*“1. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.*

*2. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë”.*

Pika 1, e nenit 5 , të këtij Ligji përcakton se:

*“Përmbartuesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.*

Neni 35 , pika 1, shkronja dh) e ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, të ndryshuar, ngarkon me përgjegjësi, me shkarkim nga detyra, përmbartuesin gjyqësor, duke përcaktuar se:

*“1.Përmbartuesi gjyqësor shkarkohet nga detyra në këto raste:*

*a) kur dënohet për kryerjen e një vepre penale;*

*b) kur kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë;*

*c) kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të disiplinës dhe nuk i është hequr masa e dhënë më parë;*

*ç) kur provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake ose të personave me të cilët ka lidhje familjare;*

*d) kur provohet se me veprimet ose mosveprimet e tij ka krijuar favore të padrejta për persona të tjerë;*

*dh) kur nuk përmbush veprimet përmbartimore të parashikuara në ligj;*

*e) kur është vlerësuar “i paaftë” në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji”.*

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim, K.Pr.C), në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se, janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

*“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;*

*b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;*

*c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;*

ç) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;  
d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;  
dh) kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato;  
e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre”.

Në nenin 515 dhe 524, të tij, K.Pr.C, ka përcaktuar se: “Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit...”.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, të ndryshuar, dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përmbaruesi gjyqësor.

Referuar shkresës me nr. 14667 prot., datë 14.11.2019, të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, me lëndë: “Urdhër për ekzekutim vendimi gjyqësor”, drejtuar shtetases V. D (pala debitore), evidentohet se nga ana e përmbaruesit gjyqësor, z. E. D, (me kërkesë të palës kreditore, z. A. Ç) është urdhëruar si vijon:

- “Pala debitore V. D së bshku me fëmijët K. Ç dhe F. Ç, të paraqiten pranë ambienteve të Zyrës Përmbarimore Tiranë, në datën 22.11.2019, ora 15:00, në zbatim të Vendimit nr. 463, datë 28.03.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Pala kreditore A. Ç, të jetë i pranishëm pranë ambienteve të Zyrës Përmbarimore Tiranë, në datën 22.11.2019, ora 15:00.
- Për debitorin që refuzon ose nuk kryen sipas asaj që ka vendosur Gjykata, do të gjobitet deri në 50.000 lekë si dhe kallëzim për ndjekje penale për pengim të ekzekutimit, bazuar në nenin 320, të Kodit Penal...”

Pra, në këtë kontekst, bazuar në rastin në fjalë, Komisioneri vlerëson se, nëse përmbaruesi gjyqësor i Zyrës Përmbarimore Tiranë, (si pjesë e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë), nuk ka zbatuar Urdhrin e Ekzekutimit të Gjykatës së Apelit Tiranë (në përmbushje të Vendimit nr. nr. 463, datë 28.03.2018), ai nuk ka përmbushur detyrimin e tij në zbatim të detyrave funksionale, konform përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, të ndryshuar.

Në këtë kontekst, Komisioneri, vëren se, pretendimi i subjektit ankues, për moszbatim apo zbatim formal, të vendimit respektiv të Gjykatës së Apelit Tiranë, lidhur me privimin nga e drejta për të takuar e patur kontakte me dy fëmijët e tij të mitur, në atë kohë (Aktualisht djali K. Ç nuk



konsiderohet më i mitur, pasi është i datëlindjes 29.06.2006 dhe ka mbushur moshën 18 vjeç) mund të zgjidhet vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimit përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, sipas parashikimeve ligjore të K.Pr.C.

Neni 610 i K.Pr.C., ka parashikuar shprehimisht, se, kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin.

Neni 321 , i Kodit Penal, përcakton se: *“Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet e lindura nga dënimet plotësuese të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet”*.

Për rrjedhojë, trajtimi i kësaj kërkesë të ankuesit, nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”*

Lidhur me pretendimin e ankuesit se punonjësit e Zyrës Përmbarimore Tiranë, kanë shpërdoruar detyrën përmes njëanshmërisë së manifestuar, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së<sup>5</sup>.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”*.

Neni 248 , i po këtij Kodi, përcakton se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbarim të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të*

---

<sup>5</sup> Për analogji citojmë Vendimet e KMD-së: me nr. 46, datë 07.03.2022, nr. 127, datë 23.06.2022, nr. 152, datë 28.07.2022, nr. 36, datë 09.03.2023.

*personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.*

Neni 253 , i po këtij Kodi, përcakton se: *“Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”.*

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.*

*Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.*

*Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.*

*Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1 të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”.*

Komisioneri informon ankuesin se, ankimimi kundrejt veprimeve apo mosveprimit të organeve shtetërore të tilla si Zyra Përmbartimore Shtetërore, në rastin konkret, bëhet pranë organeve kompetente të drejtësisë si, Prokuroria apo Gjykata, dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve si prokuroria e gjykata, bazuar në pretendime që lidhen me kundravajtje apo vepra penale të parashikuara në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë , apo për më tepër kontrolli i vendimmarrjeve të Prokurorisë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj .

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”.*

- **Lidhur me pretendimet e ankuesit kundrejt shtetases V. D, përsa i përket moszbatimit të Vendimit nr. nr. 463, datë 28.03.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pengimit të tij për të takuar fëmijët.**

*Së pari*, pretendimet e paraqitura nga subjekti ankues kundër shtetases V. D, nuk mund të shqyrtohen nga Komisioneri, pasi bazuar në pikën 1, të nenit 7, të LMD<sup>6</sup>, ky ligj siguron mbrojtje nga diskriminimi nga: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë<sup>7</sup> që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë<sup>8</sup> ose privatë<sup>9</sup>, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash”.

Pra, znj. D, në rastin konkret, sipas parashikimeve të bëra në LMD, nuk përmbush kriteret formale për legjitimimin e saj (*legjitimimi pasiv*) si subjekt kundër të cilit mund të paraqitet ankesë pranë KMD-së<sup>10</sup>.

*Së dyti*, lidhur me pretendimin e paraqitur nga ankuesi se ish-bashkëshortja e tij, znj. D nuk zbaton vendimin gjyqësor duke i mohuar atij të drejtën e takimit e ruajtjes së kontaktit me fëmijët e tij (theksojmë faktin se njëri nga fëmijët, djali K. Ç aktualisht nuk është më i moshës minorene pasi ka mbushur moshën 18 vjeç), mund t’i drejtohet organeve kompetente përgjegjëse.

### PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 20/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/dh, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues A. Ç, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

---

<sup>6</sup> Shkurtesë për “Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>7</sup>Sipas përcaktimeve të Kodit Civil, neni 24 citon: “Personat juridikë janë publikë dhe privatë”.

Neni 25 përcakton se: “**Personat juridikë publikë** janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen”.

Neni 26 përcakton se: “**Persona juridikë privatë** janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji”.

<sup>8</sup>**Sektori publik** mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore.

<sup>9</sup>**Sektori privat** mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimeve të nenit 26, të Kodit Civil.

<sup>10</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 54, datë 30.06.2017, të KMD-së.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**